



Nr. 39 prot

Huko datë 20/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 5 Datë 13. 06. 2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "GD-ENERGY" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit "GD-ENERGY" SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V E N D O S I :

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "GD-ENERGY" SH.P.K me administratore Znj. Vjollca HAJDARI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Leshnices dhe Dershnës**, degë të Lumit Drin për prodhim energjie elektrike në fshatin Mamëz-Surroj, Njësia Administrative Surroj, Bashkia Kukës, Qarku Kukës .

2-Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyt e mëposhtme:

-Mungon një plan kombëtar për përdorimin e burimeve ujore për hidroenergji.

-Shkatërron mjedisin dhe turizmin.

-Vështirëson jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

